



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 533/5 Prot.

Tiranë, më 08.06.2026

V E N D I M

Nr. 158, datë 08 .06. 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 73 Regj, datë 11.03.2026, paraqitur nga znj. L.T kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”³, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “moshës” dhe “gjendjes arsimore”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Ankuesja znj. L.T ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit, lidhur me procedurën e konkurrimit për pozicionin “Mjek Specialist” pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në të cilën ka qenë një nga kandidatët pjesëmarrës. Ajo pretendon se gjatë fazës së vlerësimit të dokumentacionit, kualifikimet dhe trajnimet e saj profesionale nuk janë vlerësuar në mënyrë të plotë dhe proporcionale me përmbajtjen dhe nivelin e tyre.

Konkretisht, ankuesja pretendon se ka përfunduar studimet e mjekësisë në një universitet italian me rezultatin maksimal 110 e lode, ka kryer një “Fellowship” një vjeçar në nefrologji pediatrike, si dhe ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm trajnimesh dhe kualifikimesh profesionale ndërkombëtare në fushën e mjekësisë.

Ankuesja pretendon se mënyra e vlerësimit të kriterëve të konkurrimit ka krijuar një trajtim të pabarabartë dhe potencialisht diskriminues, duke favorizuar në mënyrë disproporcionale vetëm kriterin e eksperiencës në punë, ndërkohë që në kriteret e shpallura nga QSUNT për këtë kriter cilësohet “preferohet të ketë eksperiencë në punë”. Pra, gjatë procesit të vlerësimit komisioni i ka atribuar karakter taksativ një kriteri që sipas shpalljes ka natyrë fakultative dhe opsionale, duke e përdorur atë si element përcaktues dhe me peshën më të madhe në renditjen e kandidatëve, ndërkohë që kualifikimet akademike dhe trajnimet profesionale nuk janë marrë në konsideratë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën QSUNT.

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri verifikimin e procedurës së vlerësimit dhe vlerësimin nëse mënyra e aplikimit të kritereve ka krijuar një trajtim të pabarabartë apo diskriminues, si dhe pezullimin e procedurës së konkurrimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar shprehimisht shkakun e mbrojtur “mosha” dhe “gjendja arsimore”, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 533/2 prot, datë 24.03.2026, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion në lidhje me ankesën nga QSUNT në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Me shkresën nr. 1342/3 prot., datë 05.05.2026, QSUNT ka kthyer përgjigje, duke parashtruar rrethanat faktike dhe juridike të procedurës së konkurrimit. Ndër të tjera, QSUNT parashtron:

Procesi i rekrutimit u zhvillua në bazë të Udhëzimit nr. 205, datë 09.04.2024, të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës së mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë”, nëpërmjet portalit "Mjekë për Shqipërinë", i cili administron elektronikisht aplikimin. Konkurrimi u zhvillua në dy faza, vlerësim me dosje dhe intervistë me gojë, dhe se kandidatët duhet të ngarkonin dokumentacionin brenda afatit të shpalljes.

Për znj. L.T , QSUNT shpjegon se, në fazën e parë ajo u vlerësua me 0 pikë për eksperiencë, pasi librezja e punës mungonte në dosjen e ngarkuar elektronikisht; me 4 pikë për mesataren universitare prej 8.96; me 5 pikë për specializimin me mesatare 9.9; me 2 pikë për gjuhë të huaj; me 0 pikë për gradë shkencore, pasi nuk kishte ngarkuar dëshmi doktorature; dhe me 0 pikë për kualifikime afatgjata, pasi nuk kishte dokumentacion përkatës brenda afatit. Znj. Turku ushtroi të drejtën e ankimimit ndaj pikëzimit prej 11 pikësh. Komisioni *ad-hoc* u përgjigj brenda afatit me procesverbalin e datës 10.03.2026, duke rikonfirmuar vlerësimin. Znj. Turku nuk u paraqit në Fazën II të konkursit.

Për kandidaten G.H, QSUNT paraqet vlerësimin e saj sipas kriterëve, 7 pikë për eksperiencë, 5 pikë për mesataren universitare, 5 pikë për specializimin dhe 2 pikë për gjuhë të huaj.

Lidhur me certifikatën “*Fellowship*” të paraqitur nga znj. Turku pranë Komisionerit, QSUNT sqaron se, ky dokument nuk rezulton të jetë ngarkuar në portal gjatë afatit të aplikimit dhe se afati i aplikimit ka karakter prekluziv. Institucioni sqaron gjithashtu se procedura e ankimimit pas pikëzimit të dosjes nuk ka për qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar, por vetëm verifikimin e saktësisë së vlerësimit mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur brenda afatit.

3. Nëpërmjet *e-mailit* datë 08.05.2026, palës ankuese i është komunikuar përgjigja e QSUNT. Pala ankuese nuk ka depozituar prapësimet.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtuar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

Bazuar në informacionin e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se:

QSUNT ka shpallur konkursin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin “Mjek” pranë Shërbimit të Nefrologjisë dhe Dializës, Poli i Administrimit të Integruar i Spitalit Pediatrik. Kjo shpallje është

publikuar në portalin “Mjek për Shqipërinë” në datën 13.02.2026 me afat aplikimi 13.02.2026–20.02.2026.

Në total për pozicionin e shpallur kanë aplikuar dy kandidatë, ankuesja znj. L.T dhe kandidatja G.H. Me urdhrin nr. 214, datë 17.02.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUNT, është ngritur Komisioni i Vlerësimit *Ad-Hoc* për vlerësimin e kandidatëve. Komisioni i Vlerësimit *Ad-Hoc* ka realizuar vlerësimin e dosjeve (Faza I) si më poshtë:

Ankuesja L.T është vlerësuar me 11 pikë në total, sipas kritere:

Eksperienca në profesion:	-	0 pikë (mungonte librezja e punës)
Mesatarja e Fakultetit (8.96):	-	4 pikë
Specializimi Pasuniversitar (9.9)	-	5 pikë
Gjuha e huaj:	-	2 pikë
Grada shkencore	-	0 pikë
Kualifikime:	-	0 pikë

Kandidatja G.H është vlerësuar me 14 pikë në total, sipas kritereve:

Eksperienca në profesion (6 vite 11 muaj):	-	7 pikë
Mesatarja e Fakultetit (9.23):	-	5 pikë
Specializimi Pasuniversitar (9.97)	-	5 pikë
Gjuha e huaj:	-	2 pikë
Grada shkencore	-	0 pikë
Kualifikime:	-	0 pikë

Ankuesja është njoftuar me pikëzimin e dosjes në datë 04.03.2026. Në datën 06.03.2026, ankuesja ka ankimuar rezultatin. Komisioni *Ad-Hoc*, në datën 09.03.2026, ka rikonfirmuar vlerësimin me 11 pikë. Ankuesja nuk është paraqitur në fazën e dytë të konkurrimit (intervista me gojë) të zhvilluar në datën 10.03.2026.

Në përfundim të procedurës, bazuar në vlerësimin e Komisionit *Ad-Hoc*, renditja përfundimtare e kandidatëve është si më poshtë:

- Kandidatja G.H.: 24 pikë në total (19 pikë nga vlerësimi i dosjes + 5 pikë nga intervista me gojë)
- Ankuesja L.T : 11 pikë në total (vetëm vlerësimi i dosjes, pa marrë pjesë në intervistë)

Në lidhje me certifikatën ”*Fellowship*” – Module 3 (27.08.2025–21.12.2025) të paraqitur nga ankuesja pranë Komisionerit, rezulton se ky dokument nuk provohet se ka qenë pjesë e dosjes së ngarkuar brenda afatit të aplikimit në portalin “Mjekë për Shqipërinë” dhe si i tillë nuk rezulton të jetë vlerësuar nga Komisioni *Ad-Hoc*.

Bazuar në rezultatet e vlerësimit, Komisioni *Ad-Hoc* ka vendosur për zgjedhjen e G.H, si kandidat, i cili renditet i pari, për t’u emëruar në pozicionin “Mjek”.

Ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe moshës nga ana e QSUNT. Pretendimi kryesor i ankuses konsiston në faktin se sipas ankuses, komisioni i ka atribuar karakter taksativ dhe përcaktues një kriteri që sipas shpalljes ka natyrë fakultative, duke përdorur formulimin “preferohet të ketë eksperiencë në punë”.

Komisioneri vëren se baza ligjore e vlerësimit të eksperiencës në punë nuk buron nga shpallja e realizuar nga QSUNT, por nga Udhëzimi nr. 205, datë 09.04.2024 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës së mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Udhëzimi ose Udhëzimi Nr.205/2024), i cili është akti normativ në fuqi që rregullon në mënyrë të detyrueshme procedurat e rekrutimit të mjekëve për të gjithë institucionet shëndetësore publike.

Konkretisht, Shtojca 1 e Udhëzimit, e cila është “pjesë përbërëse e këtij udhëzimi” (sipas Kreut III, pika 1), përcakton skemën e plotë të vlerësimit të dosjeve. Sipas kësaj shtojce, përvoja në punë përbën një prej gjashtë kriterëve të vlerësuar me pikë:

- Kriteri 1 – Eksperienca në punë: 1-15 pikë (një pikë për çdo vit pune)
- Kriteri 2 – Nota mesatare e studimeve të larta: 1-5 pikë
- Kriteri 3 – Nota mesatare e studimeve të specialitetit: 1-5 pikë
- Kriteri 4 – Gjuha e huaj: 0-2 pikë
- Kriteri 5 – Grada shkencore: 0-9 pikë
- Kriteri 6 – Kualifikime (minimalisht 3 muaj): 0-4 pikë

Udhëzimi përcakton që eksperienca në punë nuk përbën një kriter përjashtues (eliminues), por një kriter vlerësues me pikë, i aplikueshëm për të gjithë kandidatët. Komisioni *Ad-Hoc* ka zbatuar pikërisht këtë kriter sipas Udhëzimit dhe jo sipas një interpretimi të tij.

Formulimi “*preferohet të ketë eksperiencë në punë*” në shpallje ka kuptim të ndryshëm nga ajo që pretendon ankuesja. Ai nuk është kriter i cilësuar opsional, që mund të injorohet në vlerësim, por thjesht shpreh që eksperienca është e favorshme, në përputhje me skemën e vlerësimit të përcaktuar në Udhëzim, i cili njeh vlerën me pikë, proporcionalisht me vitet e punës. Shpallja nuk mund të devijojë nga përcaktimet dhe rregullimet që bëhen në Udhëzim, i cili është një akt hierarkikisht superior dhe i detyrueshëm për zbatim gjatë procedurës së konkurrimit.

Sistemi i vlerësimit sipas Udhëzimit, vlerëson eksperiencën dhe jo moshën. Një mjek i ri (në moshë) mund të ketë eksperiencë në punë nëse e ka filluar karrierën më hershëm, ndërsa një mjek i vjetër (në moshë) mund të mos ketë eksperiencë në specialitetin përkatës. Prandaj, fakti që ankuesja nuk ka vitet e kërkuara të eksperiencës për shkak të moshës, nuk përbën diskriminim të bazuar në moshë, por është pasojë logjike e fazës së karrierës së saj mjekësore, jo e një trajtimi të pabarabartë. Vlerësimi bazohet në një fakt objektiv dhe të verifikueshëm (vitet e punës) dhe jo në moshën si të tillë.

Kreu II, pika 6, gërma “c” e Udhëzimit, parashikon si dokument të dosjes së aplikimit “*fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë dhe gjeneralitetet e kandidatit)*”. Rezulton e provuar që ankuesja nuk ka ngarkuar librezën e punës në portalin elektronik brenda afatit të aplikimit.

Komisioni *Ad-Hoc* ka vlerësuar ankuesen me 0 pikë në kriterin e eksperiencës, sipas shtojcës 1 të Udhëzimit, ndërkohë që nuk e ka skualifikuar ankuesen nga konkurrimi. Kjo vjen në përputhje me parashikimet e Udhëzimit, i cili bën dallim të qartë midis “dokumentave të detyrueshëm për kualifikim” (mungesa e të cilëve sjell skualifikim) dhe dokumentave që japin pikë (mungesa e të cilëve sjell 0 pikë në këtë kriter). Libreza e punës nuk figuron në listën e dokumentave “të detyrueshëm për kualifikim”, prandaj mungesa e saj nuk sjell skualifikim, por vlerësimin me 0 pikë në kriterin e eksperiencës.

Sa më sipër, rezulton se, Komisioni ka vepruar sipas Udhëzimit dhe nuk ka zbatuar një kriter përjashtues në lidhje me eksperiencën, por ka zbatuar një kriter vlerësimi që buron drejtpërdrejt nga ky akt, i detyrueshëm për zbatim.

Komisioneri vëren se, kriteri i eksperiencës në punë vlen në mënyrë të barabartë për të gjithë, cilido kandidat që ka eksperiencë më të gjatë fiton pikë më të shumë, pavarësisht moshës, dhe se, kriteret e tjera si, nota mesatare, specializimi, gjuha e huaj, kualifikimet, janë plotësisht të hapura për kandidatët e rinj në moshë. Konkretisht, ankuesja ka marrë pikë të larta në kriteret që lidhen me specializimin (5 pikë) dhe gjuhën e huaj (2 pikë). Në këtë mënyrë, rezulton se sistemi i kriterëve të vlerësimit nuk e pengoi ankuesen të shfaqë cilësitë akademike.

Komisioneri vëren se, ankuesja nuk është paraqitur në Fazën II të konkurrimit, atë të intervistës me gojë, të planifikuar në datën 10.03.2026. Kjo mosparaqitje ka sjellë që ankuesja të mos pikëzohet për intervistën (deri në 5 pikë). Në këto rrethana, ankuesja ka humbur mundësinë të përmbyllë procedurën e konkurrimit përmes një rezultati të bazuar në totalin e plotë të vlerësimit. Mosparaqitja në intervistë është zgjedhje e ankueses dhe mund të përbëjë një rrethanë penalizuese të shkaktuar nga ndonjë sjellje e QSUNT.

Duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat faktike dhe juridike të shqyrtuara më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- Kriteri i eksperiencës në punë është i përcaktuar shprehimisht në Shtojcën 1, të Udhëzimit nr. 205/2024, i cili është një akt normativ i detyrueshëm për të gjitha institucionet shëndetësore publike. QSUNT nuk ka vendosur dhe as nuk mund të vendoste kriterë vlerësimi jashtë kësaj skeme. Komisioni *Ad-Hoc* ka zbatuar skemën e pikëzimit të parashikuar nga Udhëzimi.
- Kriteri i eksperiencës nuk ka karakter përjashtues. Mosngarkimi i librezës së punës nuk e skualifikoi ankuesen nga konkurrimi, por i dha asaj 0 pikë vetëm në këtë kriter. Ankuesja mori pikë të plota për specializimin (5 pikë) dhe gjuhën e huaj (2 pikë), duke treguar se sistemi i vlerësimit nuk e penalizoi. Diferenca prej 8 pikësh midis dy kandidateve në fazën e parë buron tërësisht nga dallime objektive dhe të dokumentuara, konkretisht, eksperiencia e punës (7 pikë kundrejt 0) dhe mesatarja e fakultetit (5 pikë kundrejt 4 pikë);
- Formulimi "preferohet të ketë eksperiencë në punë" në shpallje nuk ka efekt juridik mbi skemën e pikëzimit të Udhëzimit. Shpallja e vendit vakant nuk mund të anulohet apo të modifikohet kriteret e vlerësimit të parashikuara nga Udhëzimi, por ajo thjesht tregon se eksperiencia është e favorshme, gjë që është e qartë edhe nga skema e pikëzimit të Udhëzimit. Interpretimi i ankueses, sipas të cilit kjo fjali do t'i hiqte peshën pikëzuese eksperiencës, është i pabazuar;

- Ankuesja nuk ka paraqitur asnjë provë apo indicie që vlerësimi i Komisionit *Ad-Hoc* është ndikuar nga mosha e saj apo gjendja arsimore. LMD kërkon si kusht të domosdoshëm lidhjen shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të diferencuar. Kjo lidhje mungon plotësisht në rastin konkret, sepse i njëjti kriter i eksperiencës do t'i jepte 0 pikë çdo kandidati tjetër, pavarësisht moshës, që nuk kishte ngarkuar librezën e punës brenda afatit;
- Mosparaqitja e ankueses në intervistën me gojë (Faza II) e datës 10.03.2026, pasi ishte njoftuar rregullisht dhe kishte ushtruar të drejtën e ankimit, është një rrethanë e rëndësishme shtesë. Kjo zgjedhje ka privuar ankuesen nga deri në 5 pikë shtesë dhe ka bërë të pamundur konkurrimin e plotë me kandidaten fituese, e cila mori 5 pikë nga intervista.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se ankuesja L.T nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejt, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e QSUNT. Në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e QSUNT.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses znj. L.T nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, në procedurën e konkurrimit për pozicionin “Mjek” pranë Shërbimit të Nefrologjisë dhe Dializës, Poli i Administrimit të Integruar i Spitalit Pediatrik, për shkaqet e pretenduara të diskriminimit “mosha” dhe “gjendja arsimore”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)

Shkaku: Mosha, gjendja arsimore
 Fusha: Punësim
 Lloji i vendimit: Mosdiskriminim